**SHTOJCA 3**

**Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore**

| | |
|---|---|
| Emri i kompanisë | **“ Kosmonte Foods ” SH.P.K.** |
| Lloji i veprimtarisë | **Objekt frigoriferik me administratë** |
| Vendi/Lokacioni ku zhvillon Veprimtarinë | **Harilaç, Komuna Fushë Kosovë** |
| Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë | **Lulzim Begaj, Pronar** |
| Adresa | **Rruga Antenës** |
| Telefoni, fax, e-mail | **+383 49 820 082,** info@kosmontefoods.com |
| Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis | **Ilir Begaj, Përfaqësues i Autorizuar** |
| Adresa | **Rruga Antenës, Harilaq** |
| Telefoni, fax, e-mail | **+383 49 820 082,** info@kosmontefoods.com |
| Numri i vendimit të Lejes Mjedisore Paraprake | **6114 - 2/19, dt. 10.03.2020** |
| Përshkrimi i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit | **1. Certifikata e regjistrimit te Biznesit me nr. Unik Identifikues: 810828858, 29.05.2013**<br>**2. Leja Mjedisore me nr. 6114-2/19, dt. - dt. 10.03.2020, Leja Mjedisore është dhënë me afat prej 5 viteve dhe skadon me datë 10.03.2025,**<br>**3. Kontrata per Mbeturina,**<br>**4. Kontrata nga KRU “PRISHTINA” Sh.a.**<br>**5. Formulari i plotësuar sipas kushteve në shtojcën 2,** |
| Fatura e pagesës së tarifës për vazhdimin e Lejes Mjedisore | **Po** |
| Vlera financiare investuse e projektit (në euro) | **2,000,000.00 €** |
| Pesë(5) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD) | **Po** |

**Shtojca 2**

**Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore**

| | | |
|---|---|---|
| **APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE** | | |
| **1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME** | | |
| **1.1. Të dhënat për Operatorin** | | |
| 1.1.1. | Emri i subjektit | " Kosmonte Foods " SH.P.K.- Objekt frigoriferik me administratë |
| | Vendi | Harilaç, Komuna e Fushë Kosovës |
| | Adresa | Rruga Antenës |
| | Nr. i tel./fax | +383 49 820 082 |
| | E-mail | hr@kosmontefoods.com |
| 1.1.2. | Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit | 810828858, Data e regjistrimit - 29.05.2016 |
| 1.1.3. | Personi Përgjegjës i kompanisë | Lulzim Begaj Pronar,<br>Ilir Begaj, Përfaqësues i Autorizuar |
| | Nr. i tel./fax | +383 49 820 082 |
| | E-mail | hr@kosmontefoods.com |
| 1.2. Të dhënat për impiantin | | |
| 1.2.1. | Emri i impiantit | " KOSMONTE FOODS" SH.P.K.- Objekt frigoriferik me administratë |
| 1.2.2. | Adresa e lokacionit të impiantit | Rruga e Antenës |

## 2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

| | | |
|---|---|---|
| 2.1. | Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur | Objekti frigoriferik me administratë është i pozicionuar në zonën kadastrale Harilaq, në kuadër të Komunës së Fushë Kosovës. Lokacioni ndodhet në afërsi të magjistrales M9, me të cilën ka lidhje të drejtpërdrejtë, duke mundësuar qasje të përshtatshme në rrjetin rrugor kombëtar dhe lehtësuar operacionet logjistike të ndërmarrjes.<br><br> |
| 2.2. | Numri kadastral i parcelës | Lokacioni i objektit frigoriferik me administratë gjendet në parcelën kadastrale me numër identifikues P-72514003-00788-0, e cila është pjesë përbërëse e zonës kadastrale Harilaq, në kuadër të Komunës së Fushë Kosovës.<br><br> |
| 2.3. | Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë | Lokacioni i objektit frigoriferik me administratë, ndodhet ne lokalitetin e Harilaç, të Komunës së Fushë Kosovës, ku ky fshat Kufizohet me fshatrat Sankoc, Sllatinë e Madhe, Mirenë dhe Vrellë e Goleshit. |




Në afërsi të objektit frigoriferik me administratë janë të pozicionuara disa struktura të tjera të karakterit, bisnes afarist dhe hotelier. Më konkretisht, në një distancë prej 296.61 metrash ndodhet betonjera EU Beton Sh.p.k., ndërsa objekti administrativ i JYSK Logistics gjendet në një largësi prej 200.08 metrash. Po ashtu, objekti i kompanisë Papperlapapp është i vendosur në një distancë prej 189.94 metrash nga lokacioni në fjalë. Përveç këtyre strukturave afariste, në zonë janë të pranishme edhe objekte të karakterit hotelier, përfshirë Motel Pisha, i cili ndodhet në një distancë prej 496.99 metrash nga objekti frigoriferik.




Objekti frigoriferik me administratë është i pozicionuar jashtë zonave të banuara, ku distanca më e afërt nga vendbanimet përreth është rreth 1.55 kilometra, gjë që siguron një shkallë të përshtatshme izolimi nga zonat rezidenciale dhe minimizon ndikimet potenciale mjedisore dhe sociale mbi popullatën lokale.

| | | |
|---|---|---|
| | |  |
| 2.4. | Të dhënat lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion | Fusha e Kosovës, e vendosur në pjesën qendrore të territorit të Republikës së Kosovës, paraqet një zonë me karakteristikë të theksuar aluvionale dhe me ndikim të lartë antropogjen për shkak të urbanizimit, industrializimit dhe intensifikimit të aktiviteteve bujqësore. Si rezultat, peizazhi natyror është ndjeshëm i transformuar dhe ka pësuar reduktim të konsiderueshëm të habitateve natyrore. Megjithatë, në këtë territor ende janë të pranishme elemente përfaqësuese të biodiversitetit, si në aspektin e florës ashtu edhe të faunës, të cilat mbajnë vlera ekologjike dhe krahinore.<br>Flora karakterizohet kryesisht nga bimësi e ultësirave kontinentale me dominim të specieve barishtore, ku më të përhapura janë përfaqësuesit e familjes Poaceae, siç janë *Lolium perenne*, *Agropyron repens* dhe *Festuca spp.*, si dhe të familjes Fabaceae, përfshirë *Trifolium pratense* dhe *Medicago sativa*. Në zonat e degraduara vërehet prani e specieve ruderal, si *Urtica dioica*, *Chenopodium album* dhe *Amaranthus retroflexus*, ndërsa në zonat periferike të paurbanizuara mund të identifikohen fragmente të bimësisë së stepës dhe livadheve të lagështa, ku rriten edhe disa specie me përdorim mjekësor dhe aromatik si *Achillea millefolium* dhe *Plantago lanceolata*.<br>Sa i përket faunës, në aspektin ornitologjik, territori përfaqësohet nga lloje të zakonshme të përshtatura me mjedise të hapura dhe të modifikuara nga njeriu, si *Corvus corone*, *Columba livia*, *Passer domesticus* dhe *Falco tinnunculus*. Fauna e gjitarëve të vegjël është e përfaqësuar me speciet si *Mus musculus*, *Rattus norvegicus* dhe *Erinaceus europaeus*, që janë të adaptuara në mjedise urbane dhe bujqësore. Amfibët dhe zvarranikët janë |

| | | |
|---|---|---|
| | | të kufizuar për shkak të ndotjes së ujërave dhe fragmentimit të habitateve, megjithatë në zona me lagështi hasen *Bufo bufo* dhe *Lacerta agilis*. Një rol të rëndësishëm në strukturën ekologjike e zë edhe fauna entomologjike, ku vërehet prania e specieve të zakonshme si *Apis mellifera*, *Coccinella septempunctata* dhe *Pieris brassicae*, të cilat kontribuojnë në proceset e polenizimit dhe kontrollin natyror të dëmtuesve. |
| 2.5. | Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtura | Në afërsi të lokacionit për të cilin kërkohet vazhdimi i Lejes Mjedisore për objektin frigoriferik me administratë, nuk janë evidentuar zona të veçanta të mbrojtura me status të veçantë mjedisor. Megjithatë, në një distancë prej rreth 1.63 kilometrash ndodhet Zona e Mbrojtur Natyrore "Goleshi"  |

**3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË**

**3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore**

<table>
<tr><td>3.1.1.</td><td>Skema e procesit teknologjik</td><td>Ne rastin tone, nuk kemi proces teknologjik, kemi vetëm proces të punës.<br><br></td></tr>
<tr><td>3.1.2.</td><td>Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik</td><td>Pajisjet te cilat mundësojnë procesin punës për ketë kompani janë:<br>- Makineritë për transport te mallrave (Kamion te ndryshëm frigoriferik me temperatura te kontrolluar).<br>- Pajisje për pranim dhe shkarkim te mallrave (Rampat për shkarkimit, Paletare eklektikë dhe manuale, Ashensorët për paleta).<br>- Pajisjet për kontrollin e cilësisë (Termometra dixhital, Skanerë barkodesh, Pajisje për matjen e lagështisë dhe matjen e ajrit).<br>- Pajisjet e magazinimit dhe ruajtjes (Frigoriferë industrial, dhomat frigoriferike, Rafta te larta).<br>- Pajisjet për përgatitjen dhe paketimin e porosive (Pajisjet për paketim dhe mbështjellës, Pirunier transportues, Pajisjet etiketimi dhe</td></tr>
</table>

orientimi).

Procesi i punës ka ketë rrjedhje te punës:

1. **Hyrja dhe Pranimi i produkteve -** Procesi fillon me **importimin dhe pranimin e produkteve ushqimore** që vijnë nga furnitorë ndërkombëtarë. Mallrat transportohen me **kontejnerë frigoriferikë** për të garantuar ruajtjen e zinxhirit të ftohtë gjatë gjithë rrugës.

Në pikën e hyrjes në objekt (zona e shkarkimit), kryhet kontrolli fillestar:

- **Verifikimi i dokumentacionit** (certifikatat e origjinës, faturat doganore, certifikatat e analizave).
- Inspektimi fizik i produkteve për dëmtime të mundshme në paketim ose shenja të devijimeve të temperaturës.






2. **Kontrolli i cilësisë dhe sigurimi i standardeve -** Pas pranimit, produktet kalojnë në fazën e **kontrollit të brendshëm të cilësisë**,

| | | |
|---|---|---|
| | | që përfshin:<br>• Matjen e temperaturës së brendshme të produkteve për të verifikuar ruajtjen e kushteve të transportit.<br>• Kontroll vizual për Integritetin e paketimit dhe Etiketat dhe datat e skadencës.<br>• Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.<br>3. **Magazinimi dhe ruajtja** - Produktet vendosen në **magazinat e specializuara** të Kosmonte Foods. Kompania posedon gjithsej 17 dhoma frigoriferike me temperatura te ndryshme qe varinojna nga -18°C për produkte të ngrira, +4°C për produkte të freskëta, +2 deri +4°C për produkte të qumështit, dhe temperature ambienti për produkte të thata dhe pije.<br><br>Sistemi **ERP/WMS** përdoret për: Menaxhimin e stokut në kohë reale, Faturimin dhe financat,Menaxhimin e blerjeve dhe shitjeve, Gjurmimin |

e çdo produkti sipas datës së skadencës dhe vendndodhjes, Lëvizjet e produkteve brenda dhe jashtë magazinës (hyrje/dalje), Optimizimin e hapësirës së magazinës.

4. **Përpunimi dhe përgatitja e porosive** – Pasi klientët si supermarket, restorante , HORECA , vendosin porosite, atëherë sistemi i brendshme fillon përpunimin e kërkesave te klientëve.



- Punonjësit përgatisin mallrat sipas listës së porosive duke i paketuar në mënyrë të sigurt dhe higjienike.
- Para dërgimit, kontrollohet sërish temperatura dhe integriteti i mallrave.



5. **Transporti dhe shpërndarja -** Mallrat shpërndahen me automjete frigoriferike, duke ruajtur temperaturat gjatë gjithë rrugës deri te klienti. Kamionët janë të pajisur me sensorë të temperaturës për monitorim në kohë reale. Shpërndarja mbulon të gjithë territorin e Kosovës, Shqipërisë dhe rajonin.

| | | |
|---|---|---|
| | | 6. **Trajtimi i produkteve të kthyera dhe mbetjeve -** Në rast rikthimesh (produkte të dëmtuara ose të skaduara), aplikohen procedura të veçanta për eliminimin e tyre në përputhje me legjislacionin mjedisor. Paketimet e dëmtuara dërgohen për riciklim tek kompanitë partnere. Mbetjet organike menaxhohen përmes kontratave me operatorë të licencuar të mbeturinave. |
| 3.1.3. | Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve | - Punohet 5 ditë të javës nga 8 orë në ditë, prej orës 08:00 deri në ora 16:00. |
| 3.1.4. | Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor | Kapaciteti i projektuar i dhomave frigoriferike është si ne vijim:<br>a) 4 Dhoma frigoriferike (DhF1, DhF2, DhF3, DhF4) me sipërfaqe prej 36x6 =216m² x 7,5m'= 1620m³ x 4=6,480 m³<br>b) 5 Dhoma frigoriferike (DhF5, DhF6, DhF7, DhF8, DhF9) me sipërfaqe prej 36m²x3=108m² x 7,5m'= 810m³ x 5=4,050 m³<br>c) 1 Dhome ambienti (DhF10) me sipërfaqe prej 36m² x18 =648m² x 7.5m'= 4,860 m³<br>d) 3 Dhoma ambienti (DhF11, DhF12, DhF13) me sipërfaqe prej 36m²x6 =216m² x 7,5m'= 1620 m²x 3=4,860 m³<br>e) 3 Dhoma freskuese ose ngrirës (DhF14, DhF15, DhF16) me sipërfaqe prej 36m²x6 =216m² x 7,5m'= 1620 m³ x 3=4,860 m³<br>f) 1 Dhome ambienti (DhF17) me sipërfaqe prej 36m² x21 =756m² x 7,5m'= 5,670 m³<br>g) Koridor 29 x 36m²=1,044m² x 5m' =5,220 m³<br>h) Ekspediti 22 x 36m² =792m² x 5m' = 3,960 m³.<br>Volumi i mallrave të magazinuara bazohet në analizat empirike të ekipit menaxhues të Kosmonte Foods, i adaptuar në përputhje me periudhat e ndryshme të vitit. |

| | | |
|---|---|---|
| | |  |
| 3.1.5. | Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse. | Me mbi 1000 produkte nga mbi 100 brende të ndryshme,Kosmonte Foods sjell produktet më të mira nga prodhues evropianë e botërorë që kanë traditë shekullore.<br><br>Produkte të qumështit, Produkte të mishit, Produkte peshku, Proteinë, Pije, Snack, Ëmbëlsira, Fruta dhe perime, Mjaltë dhe reçel, Produkte nga brumi, Salca, Produkte Pa Gluten, Produkte Vegane, Vaj dhe Yndyrna, Produkte të ngrira, produkte pa laktozë, Pije Alkoolike, Melmesa, Këpurdha, Oriz, Ullinj, Patate te bluara, Kafe dhe Qaj, Vezë, Pasta, Produkte Tjera.<br><br>Zott, Perutnina Ptuj, Ferrero, Muller, Mi99, Woerle<br>Pomurske Mlekarne, Bayernland, Violife, Ghidetti, Granobile, Gjirofarm<br>Fresh Food, Olympus, Joya, Capro, Remia, Martini<br>Premier Food, Nestle, Giovanni Rana, Dijo, Koshaki, Franz Krainer<br>Greisinger, UKA, Rea's, Ocean Fish, Premium Tuna, Super Frango<br>Ronsard, Prim's, T. Boer & Zn, Iglotex, Hortex, Aviko |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Gedimex | Vandemoortele | London Dairy | Capri Sun | Loyd | Mokate |
| Cavaliere | Tanem | Tekmar | Happy | Swiss Alps | Balconi |
| Violanta | Kupiec | Dr Karg's | Ruf | Kartoffelland | Leverbrook |
| Enka Food | Powermints Gmbh | Cavendish Harvey | Levante | Lutece | Regina |
| Rita | La Regina Del Pomodoro | Castello | Zuegg | Mjalta Natura | Mb Impex |
| Terrecarsiche | Lol Tun | Arnaoutelis | Essi Group | Zbyszko | Mare Aperto |
| Marlenka | Cesvaines Piens | Palermo | Briette | Dorblu | Menprom |
| Efil | Frozy | Stavros Nendos S.A | Salutare | Mexilla | Nett |
| Rama | Frischli | Lestello | Agrostar | Vici | Bezgluten |
| Ok Snacks | Euro Vrt Ptuj d.o.o | Formalactis | Proper Pizza | Grafschafter | Beg |
| Gazi | Gold Valley | Akadia | Emmi LTD | Exquisa | Noa |
| Miree | Philips | Viotros | Vilvi | Sutdiyari | Alpha Gefsi |
| Knorr | Carte D'Or | Illyria Group | Parmalat | | |

Energjia elektrike dhe furnizimi me ujë, janë lende ndihmese. Ku energjia elektrike shfrytëzohet për administratë dhe frigoriferë, uji përdoret për nevoja sanitare.

| | | |
|---|---|---|
| 3.1.6. | Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre | Kompania posedon 2 rezervuar, të naftës dhe te benzinës te cilët i përdor për nevojat e kompanisë. Kapaciteti i tyre është:<br>Rezervuari me nafte V=41241 litër, Rezervuari me benzine V=8753 litër.<br> |
| 3.1.7. | Lista e legjislacionit në fuqi | Lista e Ligjeve dhe rregulloreve,<br>Për plotësimin e formularit për vazhdimin e Lejes Mjedisore për objektin frigoriferik me administratë “Kosmonte Foods” SH.P.K.<br>Ligjet<br>• Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025<br>• Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060<br>• Ligji Nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja<br>• Ligji për VNM Nr. 08/L181<br>• Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102<br>• Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr.08/L-261<br>• Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233<br>• Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147<br>Udhëzimet Administrative<br>• Udhëzim Administrativ(MMPHI) Nr.01_2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04_2022 për Leje Mjedisore |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Udhëzimi administrativ- nr. 13/2013 Për katalogun Shtetëror të mbeturinave<br>• Udhëzimit Administrativ nr. 06/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.<br>• Udhëzimi administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shakrkohet në trupin ujorë dhe në rrjetin e kanalizimit publik (02/2022) |
| **3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit** | | |
| 3.2.1 | Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit | Sistemi i menaxhimit mjedisor është instrumente qe përcakton përgjegjësitë mjedisore për secilin anëtar apo punonjës të objektit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë ndikimet mjedisore të shkaktuara nga aktivitetet apo veprimtaritë e tyre, si edhe të përcaktojnë objektivat mjedisore për të ulur ndikimet dhe për të përmirësuar performance e tyre mjedisore. Sistemi i menaxhimit mjedisor paraqitet në forma të ndryshme dhe është ajo pjese e sistemit të përgjithshëm të administrimit, që përfshin strukturën organizative, aktivitetet e planifikuara, përgjegjësitë, praktik, procedurat dhe burimet për zhvillimin, zbatimin, arritjen, shqyrtimin dhe konsolidimin e praktikave mjedisore.<br>Objekti Frigoriferik me administratë"Kosmonte Foods" SH.P.K është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një Mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm.<br>Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim:<br>• Respektimin e legjislacionit vendor<br>• Përmirësimin e komunikimit me autoritetet<br>• Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit<br>• Përmirësimin e vazhdueshëm i Mjedisit |
| 3.2.2 | Raportimi | |

| | | |
|---|---|---|
| **4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE** | | |
| 4.1. | Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse | Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse në ajër për objektin frigoriferik me administratë janë vetëm mjete transportuese (kamionë, furgonë frigoriferikë etj.) që shërbejnë për ngarkim/shkarkim dhe shpërndarje të produkteve –bëjnë lirimin e emisioneve nga nafta ose derivatet e saj ($CO_2$, $NO_x$, PM, $SO_2$, etj.). |
| 4.2. | Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit | Materiet ndotëse që lëshohen në atmosferë nga aktivitetet që zhvillohen në objektin frigoriferik me administratë kanë një ndikim të kufizuar. Burimi kryesor i këtyre emisioneve është lëvizja e automjeteve transportuese që kryejnë furnizimin dhe shpërndarjen e mallrave. Materiet ndotëse që mund të lëshohen përfshijnë:<br>➢ Dioksidi i karbonit ($CO_2$)<br>➢ Monoksidi i karbonit (CO)<br>➢ Oksidet e azotit ($NO_x$)<br>➢ Grimcat e imëta ($PM_{10}$ dhe $PM_{2.5}$) |
| 4.3. | Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse | Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse janë ato që nuk mund të identifikohen lehtësisht si pika të vetme dhe të përcaktuara të shkarkimit, por që shpërndajnë ndotje në mënyrë të përhapur dhe të shpërndarë në sipërfaqe të caktuara ose përmes aktiviteteve të lëvizshme. Në rastin e objektit frigoriferik me administratë, burimet difuzive përfshijnë:<br>1. Lëvizja e automjeteve në hapësirat e jashtme<br>• Lëvizja e kamionëve dhe mjeteve të tjera transportuese në zonat e hyrjes, daljes dhe parkimit mund të krijojë ndotje përmes:<br>o Gazrave të shkarkimit nga motorët ($CO_2$, $NO_x$, PM). |
| 4.4. | Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese | Nuk janë të nevojshme tek objekti frigoriferik me administratë |
| 4.5. | Pajisjet për de-pluhurim | Nuk janë të nevojshme tek objekti frigoriferik me administratë |
| 4.6. | Monitorimi i emisioneve | Nuk është e nevojshëm pasi e ka sipërfaqet e asfaltuara dhe bëhet mirëmbajtja e sipërfaqes gjithmonë. |

| | | |
|---|---|---|
| 4.7. | Monitorimi i Emisioneve /cilësisë së ajrit | Nuk është i nevojshëm |
| 4.8. | Raportimet | |
| 4.9. | Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit | Duke qenë se objekti frigoriferik me administratë nuk zhvillon veprimtari prodhuese apo procese të djegies dhe i gjithë territori është i shtruar me asfalt, ndotja e ajrit është minimale dhe burimi i vetëm i saj është lëvizja e automjeteve transportuese. Megjithatë, për të minimizuar edhe këtë ndikim të vogël, rekomandohen këto masa shtesë:<br>• Përdorimi i automjeteve frigoriferike me standarde **Euro 6** për uljen e emetimeve të gazeve të dëmshme (NOx, CO, PM).<br>• Kërkohet që mjetet që presin për ngarkim/shkarkim të fikin motorët, për të shmangur emetimet e panevojshme të gazrave ndotës. |
| 4.10. | Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike | Edhe pse objekti frigoriferik me administratë nuk përfshin procese industriale apo djegie të vazhdueshme, aktiviteti i tij kontribuon në mënyrë të kufizuar në emisionet e gazeve me efekt serrë, kryesisht përmes:<br>• Lëvizjes së mjeteve motorike transportuese (emitim i $CO_2$, $NO_x$),<br>Për të minimizuar këto ndikime në ndryshimet klimatike, do të ndërmerren masat në vijim:<br>**Zgjedhja e mjeteve me efikasitet të lartë energjetik**<br>• Inkurajimi i përdorimit të mjeteve transportuese që përmbushin standardet EURO 5 apo EURO 6, të cilat lëshojnë më pak $CO_2$ dhe $NO_x$.<br>**Ndalesa e motorëve gjatë qëndrimeve**<br>• Zbatimi i rregullit që mjetet të fikin motorin gjatë procesit të ngarkim-shkarkimit, për të reduktuar emetimet e panevojshme.<br>**Monitorim dhe vetëdijesim**<br>• Edukimi i stafit për praktika klimatike të qëndrueshme, si fikja e dritave dhe pajisjeve kur nuk përdoren.<br>• Përdorimi i ndriçimit LED dhe sistemeve efikase energjetike në hapësirat e administratës dhe magazinimit. |

| **5. UJI** | | |
|---|---|---|
| 5.1. | Të dhënat për shfrytëzimin e ujit | Objekti frigoriferik me administratë ujin e merr nga rrejti i ujësjellësit dhe e shfrytëzon vetëm për nevoja sanitare. |
| 5.2. | Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet e ujerave sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit | Objekti frigoriferik me administratë shkarkimin e ujërave e bënë në impiantin për trajtim të ujërave, dhe pastaj ne kanalizimin e fshatit. |
| 5.3. | Ndikimet në ujë | Pasi objekti frigoriferik me administratë furnizohet me ujë nga ujësjellësi dhe ky ujë përdoret vetëm për nevoja sanitare, ujërat e ndotura shkarkohen fillimisht në impiantin e trajtimit dhe më pas në rrjetin e kanalizimit të fshatit. Uji që del nga impianti i trajtimit është i padëmshëm dhe nuk paraqet asnjë ndikim negativ në mjedis. |
| 5.4. | Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor | Në rastin e objektit frigoriferik me administratë, ujërat e ndotura janë kryesisht të karakterit sanitar dhe teknik, pasi në objekt nuk zhvillohen procese prodhuese apo industriale që mund të gjenerojnë ndotje të konsiderueshme. |
| 5.5 | Trajtimi i ujërave të ndotura | Objekti frigoriferik me administratë kryen trajtimin e ujërave të ndotura, pasi është i pajisur me impiant për trajtimin e ujërave të zeza. |

| | | |
|---|---|---|
| | |  |
| 5.6. | Kontrolli dhe matjet | Nuk është e nevojshme të bëhet kontrolli dhe matjet e ujërave, vetëm në rastet kur kërkohet dhe dyshohet për ndotje. |
| 5.7. | Raportimi | Nuk është i nevojshëm. |
| 5.8. | Leje Ujore për shfrytëzim të ujit | Objekti frigoriferik me administratë pasi ujin e përdor vetëm për nevoja sanitare dhe higjenike nuk është e nevojshme leja ujore për shfrytëzim të ujit. |
| 5.9. | Leje Ujore për shkarkimin e ujërave | Objekti frigoriferik me administratë pasi ujin e përdor vetëm për nevoja sanitare dhe higjenike nuk është e nevojshme leja ujore për shkarkim të ujërave. |
| 5.10. | Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave | Pasi objekti frigoriferik me administratë nuk përfshin procese prodhuese apo përdorim të lëndëve të rrezikshme, ndikimi në mjedisin ujor është minimal ose pothuajse i papërfillshëm. Ujërat e ndotura që gjenerohen kanë kryesisht karakter sanitar dhe teknik, të cilat trajtohen në impiantin e dedikuar për trajtimin e ujërave të ndotura, para shkarkimit të tyre. Për rrjedhojë, rreziku për ndotje të ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore është i ulët dhe i menaxhueshëm përmes masave të rregullta teknike dhe operacionale. |

| 6. ZHURMA | | |
|---|---|---|
| 6.1. | Burimet | Burimet e vetme të zhurmës të identifikuara në lokacionin e objektit frigoriferik me administratë janë të lidhura me lëvizjen e mjeteve transportuese dhe afërsinë me magjistralen M9. Mjetet transportuese që hyjnë dhe dalin nga objekti krijojnë zhurmë gjatë procesit të ngarkim-shkarkimit, ndërsa magjistralja M9, që kalon pranë objektit, përbën një burim të jashtëm dhe të vazhdueshëm të zhurmës ambientale. Këto burime janë të natyrës difuzive dhe të përkohshme, dhe niveli i tyre i ndikimit konsiderohet minimal, sidomos duke marrë parasysh distancën nga zonat e banuara. |
| 6.2. | Kontrolli dhe matjet | Nuk kërkohet sipas Lejes Mjedisore |
| 6.3. | Raportimet | |

| 7. TOKA | | |
|---|---|---|
| 7.1. | Ndikimet në tokë | Aktiviteti që zhvillohet në kuadër të objektit frigoriferik me administratë nuk përbejnë burim të ndjeshëm ndotjeje për tokën. E gjithë zona funksionale është e shtruar me asfalt, çka eliminon rrezikun nga infiltrimi i substancave ndotëse. Po ashtu, për shkak të mungesës së proceseve prodhuese ose kimike, nuk krijohen mbetje që mund të ndotin tokën. Prandaj, ndikimi në tokë vlerësohet si minimal dhe i menaxhueshëm. |
| 7.2. | Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë | Edhe pse ndikimi në tokë nga ky lloj aktiviteti është minimal, është e domosdoshme të përshkruhen masat parandaluese dhe mbrojtëse, të cilat sigurojnë që mjedisi tokësor të mbetet i paprekur dhe i mbrojtur nga ndotjet aksidentale ose të tërthorta.<br>➢ Menaxhimi i kontrolluar i mbeturinave, duke i grumbulluar në kontenierë të mbyllur të vendosur në zona të shtruara dhe të mbrojtura.<br>➢ Pastrimi i menjëhershëm i çdo rrjedhjeje të mundshme të vajrave ose karburanteve nga automjetet, me përdorim të materialeve absorbues dhe masa parandaluese. |
| 7.3. | Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas | Pas përfundimit të aktivitetit dhe mbylljes së objektit frigoriferik me administratë, planifikohet zbatimi i një sërë masash rehabilituese me |

| | | |
|---|---|---|
| | përfundimit të aktivitetit | qëllim **rikthimin e zonës në gjendje të qëndrueshme mjedisore**, në përputhje me funksionin e ardhshëm të mundshëm të saj dhe kërkesat ligjore në fuqi. Më poshtë paraqitet përshkrimi i këtyre masave:<br>**Heqja dhe çmontimi i infrastrukturës teknike**<br>• Të gjitha pajisjet dhe instalimet frigoriferike, elektrike dhe teknike do të çmontohen dhe largohen nga objekti, në përputhje me rregulloret për trajtimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike<br>• Sistemet e ftohjes dhe impianti i trajtimit të ujërave do të mbyllen dhe çmontohen në mënyrë të kontrolluar.<br>**Largimi i mbeturinave dhe pastrimi i zonës**<br>• Të gjitha mbeturinat që mbesin pas përfundimit të aktivitetit do të grumbullohen, klasifikohen dhe dërgohen në pika të autorizuara për trajtim apo deponim.<br>• Do të realizohet pastrim i thelluar i të gjitha sipërfaqeve, përfshirë ato të brendshme dhe të jashtme.<br>**Kontrolli dhe rehabilitimi i mundshëm i tokës**<br>• Nëse gjatë funksionimit ka pasur ndonjë incident me rrjedhje të substancave ndotëse, do të kryhen analiza të cilësisë së tokës.<br>• Në rast të konstatimit të ndotjes, do të ndërmerren masa për rehabilitimin e tokës, përfshirë heqjen e shtresave të kontaminuara dhe mbushjen me material inert.<br>**Rihapja e potencialit të zonës për përdorim tjetër**<br>• Zona mund të **rifunksionalizohet për qëllime të tjera**, si përdorim për depo, shërbime logjistike, ose sipërfaqe të gjelbërta.<br>• Nëse zona nuk do të përdoret menjëherë, ajo do të **mbulohet me shtresë dheu të pastër dhe mund të gjelbërohet** pjesërisht për mbrojtje nga erozioni dhe degradimi.<br>**Njoftimi dhe dorëzimi i zonës tek autoritetet përkatëse**<br>• Pas përfundimit të rehabilitimit, do të njoftohen autoritetet komunale dhe mjedisore, duke dorëzuar një raport për masat e ndërmarra.<br>• Kjo siguron përgjegjësi institucionale dhe transparencë në lidhje me mbylljen e aktivitetit. |

## 8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

| | | |
|---|---|---|
| 8.1. | Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave | Llojet e Mbeturinave janë:<br>Mbeturina të ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.<br>Mbeturina nga mbetjet e produkteve te dëmtuara, te skeduara grumbullohen ne kontejner të posaqëm dhe dërgohen tek kompanitë e specializuara për trajtimin e tyre, ku kompania tashme posedon marrëveshje.<br>Objekti frigoriferik me administratë klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave e bënë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060.<br>Sipas katalogut shtetëror kemi të bëjmë me mbeturina komunale siç janë: |

| Mbeturina | Emri i mbeturinës | Shkalla rrezikshmërisë | Lloji i deponimit |
|---|---|---|---|
| 15 01 01 | Letër dhe karton | Jo të rrezikshme | Kontejner për mbeturina |
| 17 02 03 | Plastika | Jo të rrezikshme | Kontejner për mbeturina |
| 20 03 01 | Mbeturinat e ngurta komunale | Jo te rrezikshme | Kontejner për mbeturina |
| 15 01 02 | Ambalazh Plastike | Jo të rrezikshme | Kontejner për mbeturina |
| 20 01 08 | Mbeturina të biodegradushme nga kuzhina dhe mensat | Jo të rrezikshme | Kontejner për mbeturina |

| | | |
|---|---|---|
| 8.2. | Përshkrimi i Magazinimit apo deponimit te mbeturinave | Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim. |

| | | |
|---|---|---|
| | |  |
| 8.3. | Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave | Kompania nuk bën riciklimin e mbeturinave, por ka marrëveshje me kompani për riciklim të mbeturinave të mbetura nga procesi i punës. |
| 8.4. | Dërgimi për trajtim dhe riciklim te operatori tjetër – kontrate me kompaninë me leje përkatëse | Kompani “Kosmonte Foods” ka marrëveshje me një kompani të specializuar, e cila merret me përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave. Mbetjet grumbullohen në kontejnerë të dedikuar brenda objektit, ndërsa një herë në javë kompania e kontraktuar i tërheq ato për t’i dërguar në procesin e përpunimit dhe riciklimit. |
| 8.5. | Plani për menaxhimin e mbeturinave | Objekti Frigoriferik me Administratë “Kosmonte Foods” SH.P.K. nuk ka hartuar Planin për menaxhimit me mbeturina. |
| 8.6. | Raportimi | Nuk bëhet raportimi |

| 9. RREZIKU NGA AKSIDENTET | | |
|---|---|---|
| 9.1. | Plani për pengimin e aksidenteve ne rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm | Objekti frigoriferik me administratë “Kosmonte Foods” SH.P.K. gjatë zhvillimit të aktiviteti nuk është i nevojshëm plani për pengimin e aksidenteve aty mund të ndodh vetëm prishja apo djegja e ndonje pasije në raste të ndonjë defekti. |
| 9.2. | Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masavepër zëvendësimin e tyre | Objekti frigoriferik me administratë “Kosmonte Foods” SH.P.K. gjatë zhvillimit të aktiviteti të saj nuk përdor substanca të rrezikshme kimike. |
| 9.3. | Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave | Për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave Objekti frigoriferik me administratë “Kosmonte Foods” SH.P.K ka marre këto masa.<br>• Kryerja e inspektimeve të rregullta të objektit për të identifikuar rreziqet e mundshme dhe për të adresuar problemet para se ato të shkaktojnë aksidente.<br>• Trajnimi i stafit për të përdorur pajisjet e sigurisë dhe për të ndjekur procedurat e sigurisë. |
| 9.4. | Raporti mbi gjendjen e sigurisë | Kompleksi “Kosmonte Foods” ka të hartuar raportin mbi gjendjen e sigurisë dhe është i pajisur me të gjitha elementet e nevojshme për shuarjen e zjarrit në rast të ndonjë ndezjeje. |

## 10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT

| | | |
|---|---|---|
| 10.1. | Ndërprerja momentale e punës së impiantit | Nuk ka ndërprerja momentale të punës së Objektit frigotifrtik me administratë. |
| 10.2. | Ndërprerja e punës | Ndërprerja e punës nuk ka |

## 11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHENDETIN E NJERIUT

Gjatë funksionimit të deritanishëm të objektit frigoriferik me administratë të kompanisë “Kosomonte Foods” SH.P.K., nuk janë evidentuar ndikime negative në shëndetin e njeriut apo në mirëqenien e komunitetit përreth. Përkundrazi, objekti ka pasur ndikim pozitiv në aspektin socio-ekonomik, duke mundësuar punësimin e banorëve lokalë dhe duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të zonës.

Objekti është i vendosur në një zonë me karakter afarist dhe industrial, larg zonave të banuara – vendbanimi më i afërt gjendet në një distancë prej rreth 1.55 km, çka përjashton mundësinë e ndikimeve të drejtpërdrejta ndaj popullatës. Po ashtu, zona është e përfshirë tërësisht me asfalt, dhe e gjithë ndotja potenciale është e lidhur vetëm me lëvizjen e automjeteve transportuese, e cila është e përkohshme, e kontrolluar dhe me ndikim të ulët.

Ky raport është hartuar me qëllim informimi dhe konfirmimi se “Kosomonte Foods” SH.P.K. nuk ka bërë asnjë rritje të kapacitetit, zgjerim të veprimtarisë, apo ndryshim në karakterin e aktivitetit në raport me Lejen Mjedisore ekzistuese. Aktiviteti mbetet i njëjtë, pa shtim të burimeve ndotëse apo ndërhyrje në strukturën funksionale të objektit.

Për pasojë, bazuar në vlerësimet teknike dhe mjedisore të përfshira në këtë raport, mund të konkludohet se objekti nuk paraqet rrezik për shëndetin e njeriut, dhe ndikimi i tij në mjedis mbetet minimal, i kontrolluar dhe i menaxhueshëm, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e lejuara.

| | |
|---|---|
| **Personi Përgjegjës për Mjedis** | **Personi përgjegjës i Kompanisë** |
| **Emri Mbiemri** | **Emri Mbiemri** |
| Ilir Begaj | Lulzim Begaj |
| **Nënshkrimi** | **Nënshkrimi** |
| ______________________ | ______________________ |